



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1321 / Prot.
17

Vlorë, më 07.07.2023

VENDIM

Nr. 33, datë 06.07.2023

PËR
SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.44 TË SENATIT AKADEMIK, DATË 20.08.2019 "PËR
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË NENIN 9 NË STATUTIN E UNIVERSITETIT
"ISMAIL QEMALI", VLORE.

Në mbështetje të nenit 33 pika 1, 38 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, nenit 113 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" si dhe referuar propozimit të Rektorit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, ardhur me shkresën nr.1295/1, prot, datë 04.07.2023, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.07.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Rektorit për shfuqizimin e Vendimit nr.44, të Senatit Akademik "Për miratimin e një ndryshimi në nenin 9 në Statutin e Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë.
2. Emri i kësaj njësie kryesore do të qëndrojë "Fakulteti i Shkencave Humane".
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi "Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë", Zëvendësrektori Akademik, Drejtorja e Ciklit të I dhe të II të studimit".
4. Ky vendim përcillet për miratim të mëtejshëm Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETRI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland Zisi

